



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:160305

Datë: 05.01.2024

Numri i dokumentit: 05160109

C.190/2021

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm,- Divizioni Civil, gjyqtari Riza Livoreka, si gjyqtar individual, me bashkëpunëtoren profesionale Valmira Sejdiu Raçi, në çështjen juridike kontestimore te paditësve Sh. T. , K. G. , T. K. , B. H. dhe Z. M. nga Kaçaniku, të cilët me autorizim e përfaqëson avokat F. T. nga Kaçaniku, kundër të paditurës K. K. – D. A. K. , në çështjen kontestuese kompensimi mbi bazën e kualifikim- (licencimi), shpenzimeve te ushqimit dhe shpenzimeve te udhëtimit, jashtë seancës gjyqësore më datën 05.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

(pa shqyrtim kryesor te çështjes)

I. **MIRATOHET**, pjesërisht si e bazuar kërkesa padia e paditësve Sh. T. , K. G. , T. K. , B. H. dhe Z. M. nga Kaçaniku dhe **DETYROHET** e paditura K. K. , që paditësve në emër të kompensimit për kualifikim-licencim, për periudhën kohore prill 2017 - nëntor 2022, ushqim dhe udhëtim, për periudhën kohore shtator 2020 – deri nëntor 2022, t’ua paguaj shumat dhe atë :

a. Paditëses Sh. T.

► Në emër të shtesave për kualifikim shumën prej4,110.34 €

► Në emër të shujtës shumën prej862.28 €

► Në emër të shpenzimeve të rrugës shumën prej 302.14€

Gjithsej shumën prej 5,274.76€

b. Paditësit K. G.

- ▷ Në emër të shtesave për kualifikim shumën prej6,611.11 €
- ▷ Në emër të shujtës shumën prej862.28 €
- ▷ Në emër të shpenzimeve të rrugës shumën prej 302.14€
- Gjithsej shumën prej 7,775.53€**

Paditësit T. K.

- ▷ Në emër të shtesave për kualifikim shumën prej4,110.34 €
- ▷ Në emër të shujtës shumën prej862.28 €
- Gjithsej shumën prej 4,972.62€**

c. Paditësit B. H.a

- ▷ Në emër të shtesave për kualifikim shumën prej4,110.34 €
- ▷ Në emër të shujtës shumën prej862.28 €
- Gjithsej shumën prej 4,972.62€**

d. Paditëses Z. M.

- ▷ Në emër të shtesave për kualifikim shumën prej4,110.34 €
- ▷ Në emër të shujtës shumën prej862.28 €
- ▷ Në emër të shpenzimeve të rrugës shumën prej 302.14€
- Gjithsej shumën prej 5,274.76€**

Të gjitha këto shuma me kamatë prej 8%, duke filluar nga data 22.06.2021 (data e paraqitjes së padisë), e deri ne pagesën përfundimtare.

II. REFUZOHET, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve T. K., B. H. dhe Z. M. nga Kaçaniku, për secilin veç e veç shuma prej 302.14 € me të cilën kanë kërkuar pagesën e shpenzimeve të udhëtimit, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET pala paditëse që kësaj gjykate, të ia paguaj shumën prej 80€, në emër diferencës së taksës gjyqësore të pa paguar për padi, e cila pagë do të bëhet në afat prej 7 ditëve.

IV. DETYROHET e paditura K. K. , që paditësve t'ia paguaj shumën si ne piken I te dispozitivit te këtij aktgjykimi si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumë prej 724€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësit përmes të autorizuarit Avokatit F. T. nga Kaçaniku, me datë 22.06.2021, në Gjykatën Themelore në Ferizaj –Dega në Kaçanik, kanë parashtruar padi kundër të paditurës, K. K. - D. A. K. . Me këtë padi, paditësit kanë kërkuar, kompensimin e kualifikimit, në bazë të licencimit dhe avancimit për 27%, të pagës bazë për mësimdhënësit, përgatitje superior (fakultet 3 dhe 4 vjeçare). Ka theksuar se paditësit janë të punësuar në institucionin arsimorë në shkollën Fillore të Mesme Profesionale "...", në fshatin ..., K. K. , i cili fakt vërtetohet nga kontratat dhe vërtetimet të cilat janë në shkresat e lëndës.

I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 01.11.2023, e ka dorëzuar parashtrësën me të cilën e ka zgjeruar padinë në kuptimin objektiv dhe ka precizuar kërkesë padinë. Me këtë zgjerim kërkuar edhe kompensimin e shujtës- ushqimit në punë në lartësi prej 2€ dhe shpenzimet e rrugës për 70% të biletës të trafikut Urban dhe mësimet e kombinuara, po ashtu ka bërë precizimin e lartësisë së kërkesë padisë, dhe e ka caktuar periudhën kohore nga muaji prill 2017, deri ne muajin korrik 2021, për (52) muaj. Kompensimin për kualifikim, duke i shtuar edhe periudhën kohore duke filluar nga muaji Gusht 2021-deri në muajin Nëntor 2022, për kompensimin për shujtës dhe shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën kohore 01.09.2020 deri 30.06.2021m duke i shtuar edhe periudhën kohore gusht 2021 – nëntor 2022.

I autorizuari tutje ka theksuar se baza ligjore, e kërkesëpadisë ekziston në Kontrata Kolektive e Arsimit nr. 01B-2056 e datës 18.04.2017, me nenet 7 pika 7.3 dhe 7.4. Me këto dispozita është paraparë kompensimi në emër të kompensimit për kualifikime për të punësuarit që kanë marrëdhëniet e punës primare në institucionet e arsimit.

Ndërsa me nenin 35 pika 7, është paraparë kompensimi për ushqim ditor, të punësuarve që kane marrëdhënie pune primare ne institucionet arsimore u sigurohet kompensimi për ushqim ditorë nga 2€, për çdo ditë të pranisë në punë si dhe shpenzimet e udhëtimit, duke theksuar se

dispozitat e lartcekura janë në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 të Ligjit të Punës dhe i obligojë palët e marrëveshjes për përmbushjen e detyrimeve. Prandaj nga këto baza, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta miratoj në tersi si të bazuar.

Shpenzimet i ka kërkuar.

Gjykata konform neneve 394, 395 dhe 396 të LPK-së, e ka nxjerr aktvendimin me shkrim, te cilin e ka detyruar te paditurën që të paraqes përgjigje ne padi, te deklarohet se a e pranon apo e konteston kërkesëpadinë e paditëseve.

E paditura, më datën 18.01.2022, ka paraqitur përgjigje në padi, me të cilën i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Ka theksuar se e paditura K. K. , nuk është palë nënshkruese e kësaj kontrate, por nënshkruese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në njërin anë dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit në anën tjetër. Palët nënshkruese të kësaj kontrate kanë marr obligim që së bashku më Ministrinë e Financave të angazhohen bashkërisht për sigurimin e mjeteve financiare për komunat e Republikës së Kosovës me qëllim të realizimit te buxhetit te nevojshëm të përcaktuar në kontratën kolektive.

K. K. nuk është nënshkruese e kësaj kontrate dhe nuk ka mundësi buxhetore që të bëjë mbulimin e këtyre shpenzimeve, prandaj i ka bërë kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës që të ndërhyjë si palë nënshkruese e kësaj Kontrate duke u mbështetur ne nenin 35 te Kontratës Kolektive te Arsimit. Prandaj nga këto baza i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj ne tërësi si te pa bazuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimet e tyre për ti parashtruar ato si dhe duke u bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka administruar këto prova edhe atë: Diplomë e kualifikimit universitarë dhe Licenca e mësimdhënësit për paditësit Sh. T. , Diplomë e kualifikimit universitarë - master dhe Licenca e mësimdhënësit për paditësin K. G. , Diplomë e kualifikimit unviersitarë dhe Licenca e mësimdhënësit për paditësin T. K. , Diplomë Universitare dhe Licenca e mësimdhënëses për paditësin B. H., Diplomë e kualifikimit unviersitarë dhe Licenca e mësimdhënësit për paditësen

Z. M., Lista e pagave për muajin Prill të vitit 2021, lista e mësimdhënësve që kanë udhëtuar lëshuar nga SHFMU “...”.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të së cilës veç e veç, si dhe të ndërlidhura si tërësi në mes veti, mbi bazën e bindjes se lirë, në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së. Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe punojnë si mësimdhënës. Kjo e drejtë ju takon paditësve në bazë të kontratës kolektive. E paditura nuk i ka përmbushur detyrimet që dalin nga kontrata kolektive. Kompensimin për kualifikimi për periudhën nga muaji Prill 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 e deri në muajin Nëntor 2022. Po ashtu si ka paguar shpenzimet e udhëtimit dhe shujtave ditore, për periudhën shtator 2020 deri nëntor 2022.

a) Se paditësit janë në marrëdhënie pune, tek e paditura, në pozitën mësimdhënës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi, si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat vërtetohet se janë në marrëdhënie pune tek e paditura. Po ashtu se këta paditësit punojnë në vendin e punës mësimdhënës, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga thëniet në padi, dhe provave të bashkangjitura padisë, e ne veçanti nga licenca e mësimdhënësit. Këto fakte nuk ishin kontestuese në mes të palëve ndërgjyqese.

b) Se kjo e drejtë ju takon paditësve këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga Kontrata Kolektive e Arsimit 01B-2056, e datës 18.04.201 dhe Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, të datës 22.01.2021, edhe atë kjo e drejtë ju takon kofrom nenit 7 dhe 35 të këtyre kontratave.

c) se pala e paditur nuk e ka përmbushur, detyrimin, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar me vet faktin se paditësit kanë paraqitur padi në gjykatë. Po ashtu ky fakt vërtetohet edhe nga përgjigja në padi, e paraqitur nga e paditura e cila ka theksuar se këtë pagesa nuk janë bërë për arsyeje se nuk kanë mjete buxhetore dhe nuk janë nënshkrues të kësaj kontrate.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, përgjigjes në padi dhe precizimit të kërkesave nga pala paditëse, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht si i bazuar.

Gjykata kërkesëpadinë e ka miratuar pjesërisht si të bazuar , duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë nr 01B-2056, të datës 18.04.2017 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, të datës 22.01.2021, edhe atë në dispozitën e neneve 7 dhe 35 paraagrafi 5, 7 të kësaj kontrate.

Sipas nenit 7 par. 1, pika 1, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01B-Nr.prot.2056, e cila ka hyrë në fuqi nga data 18.04.2017, është paraparë se mësimdhënësve ju takon kompensim shtesë mbi bazën e kualifikimit, e në rastin konkret mësimdhënësit kanë Diplomë Universitare, ku në dispozitën e lartëcekur është paraparë se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi, dhe së të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit mësimdhënësit me diplomë bachelor i takon 27% e pagës bazë, mësimdhënësve me diplomë 5 vjeçare magistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë”*. Ndërsa në nenin 7 par. 1, pika 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, të datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, është paraparë së me se *“Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi, dhe të punësuarve i mundësohet kualifikim pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr.5/2017 Sistemimi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundësohet mësimdhënësve realizimi i stimulimit në të ardhura personale, si vijon: Mësimdhënësit me Licencë të karrierës 10% e pagës bazë”*.

Gjykata paditësve ua pranoi kërkesat, sa i përket shpenzimeve të udhëtimit sepse me nenin 35 par. 5 te Kontratës Kolektive të Arsimit, është paraparë se punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i paguhen shpenzimet u rrugës 70%, të biletave të trafikut urban.

Se paditësit udhëtojnë, gjykata këtë fakt e ka vërtetuar nga lista e lëshuar nga SHFMU “...” për mësimdhënësit te cilët kane udhëtuar gjate muajve shtator- nëntor te vitit 2020, nga e cila liste konstatohet se paditësit udhëtojnë dhe kjo e drejte ju takon.

Gjykata paditësve ua pranoi edhe kërkesën sa i përket kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, sepse kjo e drejtë ju takon konform nenit 35 paragrafi 7, me këtë dispozite është paraparë se të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim, për ditët e pranisë në pune, vlera e kompensimit të ushqimit, në pune, për një ditë pune është 2€, për të punësuarit që kanë marrëdhënie pune primare ne institucionet arsimore.

Gjykata sa i përket kohëzgjatjes së ditëve të udhëtimit këtë fakt e vërtetoi nga thëniet në padi, ku është shënuar se mësimdhënësit, punojnë për 185 ditë dhe për këtë kohë duhet ti paguhet kompensimi për ushqim.

Gjykata kërkesë padinë e paditësve e miratoi pjesërisht si të bazuar duke u bazuar në kontratën kolektive të arsimit edhe atë ne nenin 7 dhe 35 pika 5 dhe 7, Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme te Kosovës GJ.A. 214/2023, i datës 09.10.2023, si dhe konform nenit 245 të Ligjit nr. 04L-077, për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Me këtë dispozitë ligjore është paraparë “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Rrjedhimisht, duke qenë se e paditura i ka mbetur borxh paditëses, me aplikimin e dispozitës së lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ia kompensoj shumën si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “*Po qe se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.*” Edhe me dispozitën e nenit 398 te LPK-se, parashihet shprehimisht se gjykata mund te jap aktgjykim pa shqyrtim kryesor te çështjes nëse pas marrjes se përgjigjes ne padi, konstaton se ne mes te palëve nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante. Meqenëse janë plotësuar kushtet edhe atë: e paditura është përgjigjur ne padi pastaj pala e paditur ka theksuar se nuk ka mjete për te paguar këtë detyrim nuk e ka pohuar e as mohuar kërkesëpadinë e paditësit dhe nuk ekziston pengesa tjera për dhënien e këtij aktgjykimi.

Prandaj, bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret,

kërkesëpadia e paditëses është qartazi e themeltë dhe atë duke u bazuar në dispozitat e Kontratës Kolektive , ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marre për baze nenin 10 par.1 të LPK-së, me këtë dispozite është paraparë se “ne rast te fillimit te procedurës gjyqësore civile atëherë është obligim i gjykatës por edhe i palëve qe procesi te zhvillohet ne mënyrë sa me efikase dhe me shpenzime sa me te vogla qe është menduar”. Pra, qëllimi i kësaj dispozite është qe procesi te jete efikas i shpejte dhe i lire. Ky detyrim se pari i takon gjykatës dhe palëve pjesëmarrëse ne këtë proces.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës se palës paditëse e ka caktuar edhe kamatën duke u bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e paraqitjes se padisë pra nga data 09.07.2021, e deri ne pagesën definitive. Këtë kamat e ka caktuar duke u bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020.

Gjykata e refuzoi si të pa bazuar pjesën e kërkesëpadisë se paditësve sa i përket shpenzimeve te udhëtimit për T. K. , B. H. dhe Z. M., sepse nga lista e mësimdhënësve qe kane udhëtuar, ka gjetur se keta paditës nuk janë evidentuar në listën e mësimdhënësve që kanë udhëtuar.

Gjykata i analizoi theksimet e paditësve të paraqitura me padi dhe parashtresë mbi precizimin e kërkesëpadisë me të cilën kanë kërkuar që këto kërkesa të aprovohen në tërësi si të bazuara dhe të detyrohet e paditura qe të ia paguaj shumat si në precizimin e kërkesëpadisë.

Këtyre theksimeve gjykata pjesërisht ua fali besimin dhe vendosi si ne paraprafën I të dispozitivit të aktgjykimit sepse ketë pretendime janë të bazuara në Kontratën Kolektive te Arsimit në Kosovë nr 01B-2056, të datës 18.04.2017 dhe Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, të datës 22.01.2021

Gjykata i ka analizuar edhe theksimet e palës së paditur të paraqitura me përgjigje në padi, e cila ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet ne tërësi si e pa bazuar. Këto theksime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse nuk kishin ndikim që të vendosej ndryshe dhe e paditura ka detyrim qe këto kërkesa ti paguaj duke u bazuar ne Kontratën Kolektive te Arsimit.

Gjykata i detyroi paditësit që kësaj gjykate të ia paguaj shumën prej 80€ në emër të diferencës së taksës së pa paguar për padi, sepse me rastin e dorëzimit të padisë kanë paguar vetëm 20 €, ndërsa diferencën janë të detyruar ta paguajnë konform Udhëzimit Administrativë 01/2017, të KGJ-së.

Gjykata e detyroi palën e paditur që paditësve t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 724 €, edhe atë shumë prej 624€ për përpilimin e padisë, ndërsa shumën prej 100€, të taksës për padi. Gjykata vendimin për shpenzimet e procedurës e ka bazuar në nenin 451.1 të LPK-së, ndërsa taksën gjyqësore e ka caktuar konform udhëzimit administrativ 01/2017 të KGJK-së.

Gjykata e refuzoi kërkesën në emër të shpenzimeve për shumën prej 811.20€, për një seancë gjyqësore, sepse kjo seancë nuk është mbajtur.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

Dega Kaçanik

2021:160306, prej datës 05.01.2024

Gjyqtari,

Riza Livoreka

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.